



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

## K O N T R A T Ë

Numri i kontratës<sup>1</sup>: 616-25-5045-2-1-5/C1765

Datë: 16 / 06 / 2025

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëjërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik: "Truly Nolen" SH.P.K.; "EKOLOGJIA" SH.P.K., Dardania5-L.-2, PRISHTINË, Kosovë, me nr. të regjistrimit e biznesit: NUI 810541187, e përfaqësuar nga Alban Gunga, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Titulli: "Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës" – Negociuar me numër identifikues:

Nr i prokurimit	616-25-5045-2-1-5
Nr i brendshëm	616-25-105-2-1-5



### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

"Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës – Negociuar - Sipas pershkrimit teknik"

### Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve

Vlera totale indikative e kontratës është: 196,000.00 €; [Njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë / Euro. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është (+, - 30%).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

**Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

**3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:**

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.



Për Autoritetin Kontraktues				Për Kontraktuesin:	
Drejtor i prokurimit		Zyrtari Kryesor Administrativ		GOE: "Truly Nolen" SH.P.K.; "EKOLOGJIA" SH.P.K	
Emri:	Visar Shehu	Emri:	Përparim Rama	Emri:	ALBAN GUNGUR
Pozita:	Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit	Pozita:	Kryetari i Kryeqytetit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	13.06.2025	Data:	16/6/2025	Data:	16.06.2025
Vula:				Vula:	

# KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 616-25-5045-2-1-5/C1765

## Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 **"Ofrues i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shumën e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
  - a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
  - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguresve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura

Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditësh pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

## **Neni 5 Tatimet dhe Doganat**

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

## **Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve**

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrin me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

## **Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit**

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë të zgjatje.

## **Neni 8 Forca madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

## **Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### **Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve**

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafte të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

#### **Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve**

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimin të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veprojë në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbsisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

## **Neni 12 Obligimet e Autoriteti Kontraktues**

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkoj në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 13 Dëmet e likuiduara**

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

## **Neni 14 Siguria e ekzekutimit**

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

## **Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve**

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rrezikjet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

## **Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës**

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

#### **Neni 17            Kontrolli i kualitetit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

#### **Neni 18            Korrigjimi i defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### **Neni 19            Konsekuencat e Shkeljes se kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### **Neni 20            Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.



**Neni 21**            **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

**Neni 22**            **Dëmshpërblimi**

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

## KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 616-25-5045-2-1-5/C1765

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.


<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Nr. Nenit</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>Shqipe</b> .
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është: me nënshkrimin e planit të menaxhimit të kontratës dhe është valide për 4 muaj nga ajo date
	6.4	Data e Përfundimit është <b>4 muaj pas nënshkrimit të planit të menaxhimit të kontratës</b>
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është: <b><i>e tërë sipërfaqja e Prishtinës me të gjitha lagjet, para-lagjet dhe zonat. Në këtë projekt do të përfshihen edhe fshatrat: Bërnice e Epërme, Bërnice e Poshtme, Bardhosh, Besi, Vranidoll, Teneshdoll, Prugovc, Barilevë, Trude, Lebane, Llukar, Makovc, Mramuer, Mat, Kolovica e re, Prishtina e Re, Shkabaj, Hajvali si dhe pjesë të tjera nëse do të jetë indikativë nga ekipi menaxhues në kuadër të hektarëve të planifikuar</i></b>
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <b><i>Caktohet nga ZKA</i></b>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: <b>Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës së kontratës në afat prej 5 muajve</b>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Ofruesi i Shërbimeve do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do të sigurojë Autoritetin kontraktues dhe Menaxherin e Projektit kundër, çdo kërkesë për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ofruesi i shërbimit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tij.  <i>Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë:</i>  (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;  (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.  (c) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:



		<p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar</p> <p>(i) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar</p>
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: <i>Kërkesat për pagesë do të bëhen për shërbimet e performuara në baza mujore . Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues për shërbimet e performuara ne baza mujore.</i>
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: <i>Sipas menaxherit dhe mbikëqyrësit te kontratës</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<i>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, në pajtim me ligjin e Kosovës.</i>



## Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME



### HYRJË

Edhe në Komunën e Prishtinës sikur në pjesën më të madhe të Kosovës në vazhdimësi prej viti në vit paraqiten sëmundje të ndryshme ngjitëse si: tularemia, ethet hemoragjike, ethet e Nilit Perëndimor, sëmundja e LYME-it dhe një numër i madh i sëmundjeve tjera ngjitëse të traktit digjestiv dhe atij respirator. Një nga rrugët e përhapjes së këtyre sëmundjeve është edhe ajo e cila realizohet përmes vektorëve të cilët mund të jenë të ndryshëm: brejtës, insekte rrëshqitëse dhe insekte fluturuese si: mizat, mushkonjat etj.

Me qëllim të parandalimit të sëmundjeve që mund të shkaktojnë dëmtim të shëndetit të popullatës, KK Prishtina ka paraparë aktivitete të ndryshme nga lëmi i shëndetit publik e një ndër to është edhe zbatimi sistematik i veprimeve të dezinfektimit hapsinor me qëllim të eliminimit apo sjelljes në kufijë të tolerancës epidemiologjike të insekteve fluturuese mbi teritorin e komunës tonë.

Përmes këtij projekti synohet parandalimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse përmes vektorëve dhe përmirësimi i kualitetit të jetës për qytetaret e komunës sonë. Masat për eliminimin e mushkonjave sipas OBSH-së duhet të përfshijnë tretmanin me larvicid residual dhe spërkatjen hapësinore. Princi themelor i spërkatjes së suksesshme hapsinore është arritja e kontaktit maksimal në mes të insektit dhe insekticidit. Kjo më së miri arrihet nëse retë e aerosolit kanë madhësi optimale të grimcave (mjaft insekticid) dhe nëse kanë efikasitet të duhur sulmues. Për aksion efikas duhet të plotësohen disa kushte si: kushtet mikrometeorologjike, aplikimi i standardeve të parapara në kontekst të preparatit dhe metodës së aplikimit dhe karakteristikat e insekteve. Pastaj shumë me rëndësi është edhe përcaktimi i gjendjes reale i cili nënkupton identifikimin e insekteve që janë qëllim i eliminimit, përcaktimi i lokalitetit dhe vatrave, planifikimi i trajtimit, përcjellja e kushteve mikrometeorologjike, përzgjedhja e insekticidit, mënyra e trajtimit, monitorimi i zbatimit dhe përcaktimi i efikasitetit të veprimeve. Trajtimi kryesisht do të përqendrohet në eliminimin e mizave, mushkonjave dhe larvave të tyre andaj e shofim të nevojshme që të përmendim disa nga sëmundjet që përhapin këto dy grupe insektesh. Mizat janë vektor potencial për sëmundjet si: intoksikacionet alimentare, toxoinfeksionet alimentare, sallmoçelozat, dizenteria, gastroenteritet, tyfoidet, kolera dhe tuberkulozi. Mushkonjat jetojnë prej 10 ditë deri 6 muaj, janë rreth 3.000 lloje, mund të transmetojnë sëmundje në njerëz dhe në kafshë si : malaria, filiriaza, ethet e verdha, ethet dengue, ethet e Nilit Perëndimor, Chikungujën encefalitet si dhe shkaktojnë ndjenjë të pakëndshme dhe reaksione alergjike në rast të pickimi të njeriut.

### QËLLIMI

Me këtë projekt synohet që të arrihen këto qëllime:

- Eliminimi ose sjellja në kufijtë të tolerancës epidemiologjike të insekteve fluturuese: mushkonjat dhe mizat
- Parandalimi dhe pengimi i përhapjes së sëmundjeve transmiseve që barten përmes insekteve që shërbejnë si vektorë.
- Eliminimi edhe i shumë shakatareve tjerë të dëmtimit të popullacionit bimor.
- Krijimi i kushteve për jetë më të qetë të qytetarëve.

## ▪ AKTIVITETET

Dezinsektimi hapësinor duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për shëndetin publik dhe ligjin për mbrojtjen e mjedisit. Duhet përdorur metodat më bashkëkohore me mjete të sofistikuar me aplikim nga toka. Gjithnjë duke u bazuar në rekomandimet e OBSH dhe CDC (Centre for Disease Control) (Qendra për kontrollin e Sëmundjeve) trajtimi duhet të fillojë në fund të muajit Maj, varësisht nga kushtet klimatike (atmosferike) dhe do të kryhet në gjashtë faza.\*

\*(Vërejtje – Faza shtesë do të realizohen nëse ekspertët pranë QKMF-së, Menaxherët e Kontratës dhe Drejtorja për Shëndetësi e konsideronë të nevojshme duke u bazuar në kushtet klimatike dhe popullacionin e insekteve gjatë periudhës kur kryhet ky proces)

Projekti është paraparë të kryhet në gjashtë faza\* me një interval kohor mes tyre prej 7-10 ditë nga dita e fillimit të fazës paraprake (me mundësi të shkurtimit ose zgjatjes së këtij intervali 7-10 ditore varësisht nga situata epidemiologjike). Realizimi i një faze duhet të kryhet brenda afatit prej 4 - 5 diteve pune (deklarim me shkrim nga OE mbi realizimin e fazës brenda kohës së kerkuar) me qëllim që të arrihet mundësia e eliminimit edhe të atyre insekteve që do të zhvillohen nga forma e tyre larvare në ndërkohë, që do të thotë se nëse merret parasysh edhe koha tjetër e nevojshme për përgatitje adekuatë të tërë projekti do të zgjasë afër katër (4) muaj, gjatë një viti.

Do të trajtohet e tërë sipërfaqja e Prishtinës me të gjitha lagjet, para-lagjet dhe zonat. Në këtë projekt do të përfshihen edhe fshatrat: Bërnice e Epërme, Bërnice e Poshtme, Bardhosh, Besi, Vranidoll, Teneshdoll, Prugovc, Barilevë, Trude, Lebane, Llukar, Makovc, Mramuer, Mat, Kolovica e re, Prishtina e Re, Shkabaj, Hajvali si dhe pjesë të tjera nëse do të jetë indikativë nga ekipi menaxhues në kuadër të hektarëve të planifikuar.

Sipërfaqja që do të trajtohet është **\*6850 hektarë**. Kujdes i veçantë do të kushtohet vendeve të përshtatshme për shumë, ushqim dhe pushim të insekteve e ato janë: sipërfaqet e gjelbërta, sipërfaqet me bimësi të dendur (zona malore, parqe rekreative), lumenjtë, përrockat, depot e mbeturinave dhe vendet me dendësi të madhe të popullatës. Do të synohet që insektet të goditen në fazën e tyre më aktive e që për mushkonja është fillimi i muzgut dhe orët e vona të mbrëmjes, kurse trajtimi për miza bëhet njëkohësisht gjatë trajtimit të mushkonjave. Që të zvoglohet popullata e mizave preferohet të trajtohen më shpesh kontejnerët e mbeturinave dhe deponitë e egra të mbeturinave. KK Prishtina do të sigurojë hartën e qytetit në të cilën janë të shënuara sipërfaqet e gjelbërta, përrockat, kolektorët e kanalizimit, deponitë e mbeturinave, tregjet me shumicë si dhe ndërtesat e larta. KK Prishtina do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me MMPH-Institutin hidrometeorologjik me qëllim të përcjelljes së kushteve mikrometeorologjike dhe drejtimin e fryerjes së erërave.

Do të përdoren preparatet Biocide (për përdorim profesional) të dedikuara për dezinfektim hapësinor të jashtëm.

Larvicidet që do të përdoren janë disa lloje varësisht nga vendi i aplikimit, koha, konfiguracioni i terrenit dhe në bazë të këtyre faktorëve do të përzgjidhet larvicidi më i përshtatshëm siq janë:

- 1). *Bacillus Thuringiensis Israelensis* min. 200 (ITU/mg) granula me efekt 14 ditore. (ose ekuivalente)
- 2). *Bacillus thuringiensis subspecies israelensis* solids or liquid, spores and insecticides toxins min. 1200 (ITU/mg) me efekt të zgjatur 30 ditore. (ose ekuivalente)
- 3). Larvicide me efekt rezidual – të zgjatur veprimi deri minimum në 150 ditë i cili do të përdoret në lokacionet sensitive me materie aktive (S)-Methoprene.

Përzgjedhja e insekticidit është bërë bazuar në rekomandime e OBSH-së për tretman me insekticid ekologjik i aprovuar nga EPA ose Organizatat tjera ndërkombëtare i cili tretet lehtë me ujë, është efikas me sasi të vogël të materies aktive, me shkallë të lartë të sigurisë për njerëz, kafshë dhe ambient, të jetë fotostabil, termostabil, pa fitotoksicitet, pa arome, pa ngjyrë, pa shije dhe me veti biodegradibile. Pastaj, faktor tjetër i cili përcakton llojin e insekticidit është edhe tretmani ULV me mjegullim të ftohtë dhe tretje me ujë i cili bëhet me insekticid që janë të përzier me komponente të posaqme që mundësojnë krijimin e aerosolit dhe mjegullës aktive. Preparatet biocide ne perberjen e tyre duhet të kenë substancë me veprim të shpejtë dhe të zgjatur të veprimit. Keto preparate duhet te perdoren sipas udhezuesit nga prodhuesi dhe se substancat aktive duhet te perdoren ne sasine e caktuar te ketyre udhezimeve.

Ne preferojmë materie aktive **1. Permethrine 30% - Piperonyl Butoxide 30% ose Deltamethrin 20%**. (ose ekuivalente). Doza e materies aktive duhet të jetë qartë e përcaktuar në specifikimet e produktit.

Aparatura e cila do të pëdoret për këtë aktivitet duhet të jete e përshtatshme duke pasur parasysh ndjeshmerinë e aktiviteteve që ndërmiren e që njëherit duhet ruajtur ekuilibrat biologjik-ekologjik si dhe mbrojtjen e ambientit dhe shëndetit publik. Pajset duhet të kenë të specifikuar madhësinë e grimave të aerosolit të solucionit që shpërdahet në hapsirë, lartësinë e gjuajtjes grimave të aerosolit të solucionit etj. Gjeneratorët ULV madhsia e mikrogrimave që dalin nga ULV duhet të jetë jo më shumë se 40 µm. Gjithashtu për trajtimin e vendeve me dendësi të lartë bimësie ku nuk mund të deportojnë gjeneratorët ULV me pick up ose kamioneta do të përdoren pajse adekuate për qasje në ato lokacione e të cilat janë specifikisht të destinuar për këto aktivitete, ato duhet të jenë të fuqishme dhe me presion të ulët veprimi me rezervuar kapaciteti i të cilit duhet të jetë në sasi jo më të vogël se 700L për solucion dhe gypa të gjatë minimum 50 metra me koka shtytëse të specifikuar për dezinfektim në menyre që të depërtohet sa më thellë në zonat e dendura me bimësi, parqe rekreative e të ngjajshme. Përdorimi i këtyre aparatave bëhet për saktësi dhe mos devijim (drifting) të hudhjes së preparatit. Me këtë metodë synohet të arrihet efikasitet edhe më i lartë i zvoglimit të popullacionit të insekteve (mushkonjave, mizave, etj).

Pompat motorrike ULV të krahut do të përdoren për dezinfektimin e hapsirave urbane ku makineritë e mëdha nuk mund të kenë qasje të hynë në ato zona për dezinfektimin e rrugicave, hapsirave urbane me bimë, konteinereve të mbeturinave dhe deponive të egra që gjindën në teritorin e qytetit të Prishtinës. Gjithashtu do të përdoren për hudhjen e solucionit larvicid si ai i lëgëshëm i tretëshëm poashtu edhe i granular siq parasheh udhezuesi i aplikimit të tyre.

Për të gjitha këto aktivitete personeli profesional dhe ai teknik duhet te kene pervoje ne kryerje te ketyre sherbimeve duke i ndermarre te gjitha masat mbrojtëse sipas rregullave për përdorimin e biocideve si dhe udheheqësit e grupeve duhet të jenë të trajnuar për përdorimin e preparateve biocide dhe pajseve.

Në bazë të gjitha këtyre rekomandimeve dhe përparësive që u cekën më lartë, rrjedh se duhet të përdoren preparatet e testuara në aspektin toksikologjik dhe ekologjik, që gjenden në listën e preparatave të lejuara në listën e BE-së, EPA dhe të rekomanduara nga ana e OBSH-së . Përbërësit e këtyre substancave duhet të jenë me toksicitet sa më të ulët dhe për përdorim në hapësira publike. Preparatet duhet të jenë të dedikuara për trajtim nga toka, zbërthimi i substancës në raport me ujin të bëhet sipas udhëzimit të prodhuesit dhe sipas dozimit të përcaktuar dhe atëherë të përdoret përzjerja sipas sasisë të paraparë për sipërfaqe (1 hektar).


Me qëllim të koordinimit të punëve rreth konkretizimit të projektit dhe duke patur parasysh se është veprim me efekt të përgjithshëm, ne do të bashkëpunojmë me Ministrinë e Shëndetësisë, IKSHP-në, MMPHI, Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës me qëllim të sigurimit të informatave të nevojshme, me shoqatën e bletarëve, me mjete të informimit publik si dhe me qytetarë.

### MENAXHIMI DHE RAPORTIMI

Në kuadër të Drejtoratit për Shëndetësi do të caktohet Komisioni Mbikëqyrës për realizimin e këtij projekti i cili do të udhëzojë dhe përcjellë me përpikëri zbatimin e teknikave standarde gjatë realizimit të projektit. Planin i aktiviteteve do të jetë elastik me mundësi të plotësimit dhe ndërrimit eventual në rast të paraqitjes së nevojave të reja apo ndërrimit të mënyrës së trajtimit.

Komisioni mbikëqyrës për implementimin e projektit do të mbikëqyre vazhdimisht kryerjen e punëve në çdo fazë dhe në mënyrë sistematike do të raportojë me shkrim drejtorit të drejtoratit për Shëndetësi në Prishtinë.

Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me OE, nëpërmjet mjeteve të informimit shtypura, elektronike dhe rrjeteve sociale, radio dhe TV, do të njoftoj popullatën për kohën e veprimeve dezinfektuese me qëllim të marrjes së masave mbrojtëse për njerëzit, kafshët, e sidomos për bletët. Gjatë këtyre informatave duhet të theksohet: hapësira dhe koha e paraparë për dezinfektim.




Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër	FPP	Sasia apo fushëveprimi	Informacione shtese
Grupi 1.	Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës – Negociuar	Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës – Negociuar	93000000-8	Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës – Negociuar, 6850 hektar, në 6 faza	Vlera e parashikuar: 200,000.00 për 6 faza

Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është +/- 30%.

**PËRSHKRIMI I PARALLOGARISË - PARAMASA**

nr. Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi total pa TVSH per 6 faza	Çmimi total me TVSH për 6 faza
1 Dezinsektimi Hapsinor	Faze	6	27,683.61	32,666.66	166,101.69	196,000.00
2 Buxheti i parashikuar per 6 faza						196,000.00



Projekti " Dezinsektimi Hapsinor I Komunes se Prishtines" - Negociuar





## Garanci Ekzekutimi



Serial 070020070017247

Për **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

**DUKE PASUR PARASYSH QË**

**"Truly Nolen"Sh.P.K**

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marre përsipër të lëshoj një sigurim te realizimit lidhur me kontratën me titull

**Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës – Negociuar - Sipas pershkrimit teknik**

të dhënë me numrin e Prokurimt.

**616-25-5045-2-1-5**

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

**DHE DUKE PASUR PARASYSH QË** Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

**DHE DUKE PASUR PARASYSH QË** jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:

**PËR KËTO ARSYE** vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

**€ 19,600.00**

**Nëntëmbëdhjetë mije dhe Gjashtë qindë €**

(shuma e garancisë në shifra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm të Autoritetit kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme për realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumat brenda limiteve të

**€ 19,600.00**

(shuma e garancisë)

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

**13.06.2025**

deri më

**12.12.2025**

Lëshuar në

**Dega Prishtine**

datë

**13.06.2025**

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA**  
Agjenti: Ajtene Pakashtica





## Policë Sigurimi Përgjegjësie - Publike dhe Civile Liability Insurance Policy - Public and civil



Seria / 120020020008057

Shoqëria e Sigurimeve SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a Kosovë në përputhje me kushtet, përcaktimet, përjashtimet dhe parashikimet e Kushteve të Përgjithshme të Sigurimit të përgjegjësisë së përcaktuar në seksionin e interesit të siguruar dhe kësaj Police, do të dëmshpërblejë:

"Truly Nolen"Sh.P.K

për të gjithë shumën, e cila është ligjrisht e detyrueshme për zhdëmtimin e shpenzimeve dhe kostove të pretenduesit për çdo ngjarje të siguruar për të cilën aplikohet kjo policë dhe brenda limiteve të zhdëmtimit si më poshtë për dëmtime materiale dh dëmtime trupore (përfshirë vdekjen ose sëmundjen) të personit të tretë kundrejt pagesës së primit të sigurimit të përcaktuar më poshtë dhe shumën e siguruar që mbetet pas zbritjes për humbje ose dëmtime që ndodhin gjatë së njëjtës periudhë sigurimi, përveçse kur SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a Kosovë ka pranuar të rivendosë shumën përkatëse të sigurimit (kundrejt pagesës së primit shtesë të sigurimit)

Emri dhe Adresa e të Siguruarit Name and surname of insurer	Emri dhe Adresa e Përfituesit Name and surname of the beneficiary	Përshkrimi i Biznesit Description of business
"Truly Nolen"Sh.P.K Prishtine	"Truly Nolen"Sh.P.K Prishtine	Dezinfektim dhe deratizim

**INTERESI I SIGURUAR:** Përgjegjesi Publike dhe Civile

Perjashtuar Përgjegjesi Profesionale, Përgjegjesi e Punedhenesit, Përgjegjesi Ndotjeje, Përgjegjesia Hoteliere dhe Përgjegjesia e Drejtoreve dhe Oficerve

Dëmtimet e Mbuluara Insured items	Kufiri i Dëmshpërblimit Limit of Indemnity	Pjesa e Zbritshme Deductible	Pjesa e Zbritshme minimum Deductible absolute
<b>1. Dëmtimet Trupore Bodily Injuries</b>			
1.1 Për çdo person Anyone person	€ 2,000.00	10 %	500
1.2 Për çdo ngjarje Anyone occurrence	€ 15,000.00	10 %	500
1.3 Agregati Vjetor Year aggregate	€ 15,000.00	10 %	500
<b>2. Dëmtimet materiale Material Damage</b>			
2.1 Për çdo ngjarje Anyone occurrence	€ 2,000.00	10 %	500
2.2 Agregati Vjetor Year aggregate	€ 50,000.00	10 %	1.000

<b>Territori i mbulimit/ The territory coverage</b>	Kosove
---	--------

<b>Periudha e Sigurimit: Insured Period:</b>	Nga ora 14:04 datë Nga ora 14:04 date	13.06.2025	Deri ora 14:04 datë To 14:04 date	12.12.2025
--	--	------------	--------------------------------------	------------

<b>Primi / Premium</b>	€ 165,00	<b>TVSH/ VAT</b>	€ 29,70
<b>Totali / Total</b>	€ 194,70		

Për sa më sipër nënshkruajnë personat e autorizuar nga Siguruesi dhe i Siguruari  
As for above the persons authorized by the Insurer and Insured signa on his behalf

<b>I pagueshëm brenda datës / To be paid within</b>		<b>I SIGURUARI / Insured</b>	"Truly Nolen"Sh.P.K	<b>SIGURUESI/ Insurer</b>	SIGAL UNIQA Group AUSTRIA
<b>Nënshkruesi - Agjenti / Signature - Agent</b>	Bujar Shkodra	<b>Lëshuar në Issued in</b>	Dega Prishtine	<b>Data Date</b>	13.06.2025